



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 98

Tiranë – E premte, 29 maj 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 19/2020, datë 21.5.2020	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 85/2017 “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar.....	5645
Vendim i Kuvendit nr. 20/2020, datë 21.5.2020	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar.....	5645
Rezolutë e Kuvendit datë 21.5.2020	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2019.....	5645
Rezolutë e Kuvendit datë 21.5.2020	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2019.....	5647
Rezolutë e Kuvendit datë 21.5.2020	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2019.....	5648
Dekret i Presidentit nr. 11485, datë 21.5.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5650
Dekret i Presidentit nr. 11487, datë 22.5.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	5650
Dekret i Presidentit nr. 11491, datë 26.5.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5651
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr.21, datë 27.5.2020	Për disa ndryshime në aktin normativ nr.9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020.....	5651

Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr.22, datë 27.5.2020	Për shfuqizimin e aktit normativ nr.13, datë 2.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, miratuar me ligjin nr.34/2020.....	5652
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 27.5.2020	Për shpërblimin e punës për anëtarët dhe subjektet joanëtare të grupit negociator për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si dhe të funksionarëve të kabinetit të Kryenegociatorit.....	5653
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 6.5.2020	Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.....	5655
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 15, datë 26.5.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.....	5660
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 5605, datë 21.5.2020	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	5661



**VENDIM
Nr. 19/2020**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 85/2017 “PËR
ZGJEDHJEN E BYROSË DHE
PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Në pikën III të vendimit të Kuvendit nr. 85/2017 “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

“Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit:

1. Eljo Hysko Anëtar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 21.5.2020

**VENDIM
Nr. 20/2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 86/2017 “PËR
CAKTIMIN E KRYESIVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pikat 2, 3 dhe 4, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar “Demokraci dhe Drejtësi”,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në pikën I të vendimit të Kuvendit nr. 86/2017 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Ramazan Gjuzi caktohet Kryetar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në vend të deputetes Fatjona Dhimitri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 21.5.2020

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE PËR
VITIN 2019**

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke vlerësuar rolin e veçantë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP), në misionin e tij për garantimin e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe vendosjen e ekuilibrit mes këtyre dy të drejtave kushtetuese;

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit në zbatimin e përgjegjësisë që burojnë nga ligjet e tjera, si: ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ligji nr.71/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, si dhe ligjit nr. 113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust”;

Duke vlerësuar rëndësinë e edukimit dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve për të drejtën e informimit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale të tyre, si dhe angazhimit të tyre për të gëzuar këto të drejta;

Duke vlerësuar rëndësinë e transparencës së institucioneve në nivel vendor dhe qendror, publik



dhe privat, në kuadër të së drejtës për informim, si dhe nevojën e rritjes së transparencës dhe ndërgjegjësimit të autoriteteve publike me qëllim nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies në kuadër të së drejtës për informim, si dhe të kontrolluesve publikë e privatë në lidhje me përmbushjen e detyrimeve përkatëse, që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale;

Duke vlerësuar rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2019 dhe konstaton se:

Ka realizuar plotësisht 12 rekomandimet e lëna në rezolutën e datës 28.03.2019 të Kuvendit të Shqipërisë;

Ka prirje pozitive të rritjes së transparencës së autoriteteve publike nëpërmjet publikimit të programit model të transparencës dhe pasurimit të tij me informacion të përditësuar, e cila është rritur në 60%;

Ka përmirësim të ndjeshëm të nivelit të transparencës në 90% të rasteve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si rezultat i miratimit dhe zbatimit të programit të ri model të transparencës për këto organe;

Ka vijuar puna për mbikëqyrjen dhe garantimin e së drejtës për akses në informacion publik, duke u mbështetur në vendosjen e balancës dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit;

Ka rritje të numrit të inspektimeve në 142 të tilla, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në sektorë të rëndësishëm, për kategorinë dhe sasinë e të dhënave personale që përpunojnë apo që kanë ndikim në privatësinë e individit;

Është angazhuar në forcimin e rolit të personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale pranë kontrolluesve publikë dhe privatë, si një hallkë në procesin e garantimit të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale;

Ka vijuar puna për monitorimin e zbatimit e rekomandimeve që janë dhënë për kontrollues publikë dhe privatë në periudhat paraardhëse të raportimit duke e rritur në 60.34% numrin e rekomandimeve të zbatuara;

Ka luajtur një rol proaktiv në kuadër të përmbushjes së angazhimeve ndërkombëtare në

fushën e mbrojtjes së të dhënave, siç është hartimi i projektligjit për ratifikimin e protokollit që ndryshon Konventën “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” të Këshillit të Europës;

Ka kontribuar në zbatimin me sukses të Planit të Veprimit me Prokurorinë e Përgjithshme duke zhvilluar vizita monitoruese pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të disa rrethëve kryesore gjyqësore nga të cilat u hartuan rekomandime me problematikat dhe sugjerimet përkatëse për marrjen e masave konkrete nga ana e organeve të përfshira në proces, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;

Është angazhuar në realizimin me sukses të aktivitetit më të rëndësishëm botëror në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë;

Ka bashkëpunuar me organizata të shoqërisë civile në kuadër të projekteve të ndryshme dhe njëkohësisht ka reflektuar kontributin e tyre në të gjithë veprimtarinë e saj;

Është angazhuar në organizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere për respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2020, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

Përmirësimin e programit model të transparencës dhe modelit të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për autoritetet publike.

Forcimin e rolit të personit të kontaktit për garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave.

Monitorimin dhe dhënien e mbështetjes autoriteteve publike, si dhe marrjen e masave për krijimin dhe vënien në efikasitet brenda vitit 2020 të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit.

Mbikëqyrjen e kontrolluesve me fokus platformat online, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ose sektorë që përpunojnë të dhëna sensitive dhe të paraqesë një raport të veçantë pranë Kuvendit të Shqipërisë, që ka të bëjë me pasqyrimin e gjendjes për mbrojtjen e të dhënave personale.



Dhënien e kontributit në përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680;

Rolin aktiv në procesin e diskutimit dhe miratimit të projektligjit për ratifikimin e Protokollit që ndryshon Konventën e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.

Dhënien e kontributit në hartimin e projektligjit “Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, në kuadër të transpozimit të Direktivës 2019/1024 BE, me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtën e informimit.

Të asistojë në hartimin e kuadrit të nevojshëm ligjor për mbrojtjen e konsumatorëve/subjekteve të të dhënave personale nga thirrjet e pakërkua ose dërgimit të mesazheve me postë elektronike.

Të vijojë me monitorimin e zbatimit të detyrimeve lidhur me Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Eurojust dhe në bashkëpunim me Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Eurojust të hartojë raportin vjetor për Komisionin Europian.

Vijimin e aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe trajnuese të Komisionerit në kuadër të fushave të veprimtarisë për informimin dhe ndërgjegjësimin për të drejtat dhe detyrimet.

Miraturar në datën 21.5.2020

KRYETAR
Gramoz Ruçi

REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë:

Pas shqyrtimit të raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për veprimtarinë e vitit 2019 dhe duke mbajtur në konsideratë:

- eksperiencat e krijuara në zgjedhjet e kaluara për pushtetin vendor dhe efektet që prodhuan mungesat e regjistrimit të subjekteve zgjedhore;

- eksperiencat e deritanishme për identifikimin dhe gjetjen e subjekteve politike të regjistruara e për të cilat KQZ-ja ka në objekt shqyrtimin e pasqyrave financiare dhe kontrollin e financave;

- problematikat e zëvendësimit të vendeve të mbetura bosh për shkak të dorëheqjeve nga mandatet, apo vullnetit për mosmarrjen e mandatit sipas procedurave të Kodit Zgjedhor nga kandidatët pasues në listat shumëmemërore;

Konstaton se:

Edhe gjatë vitit 2019, për shkak të bojkotit të deklaruar nga subjekte politike, që kanë qenë historikisht subjekte zgjedhore, KQZ-ja u ndodh në situata të ngjashme me ato në të cilat u vu gjatë periudhës parazgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e vitit 2017;

KQZ-ja nuk ka arritur të plotësojë të gjitha rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë për vitin 2018”.

Kuvendi i Shqipërisë për sa më sipër, i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që gjatë vitit 2020, përveç kryerjes së detyrave funksionale të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, të fokusohet edhe në këto drejtime:

Të miratojë program pune të posaçëm për vitin në vazhdim duke konsideruar që viti në vazhdim nuk është vit zgjedhor dhe në këto kushte ai duhet t'i shërbejë institucionit dhe administratës për organizimin dhe plotësimin e veprimtarive që janë të pamundura në një vit zgjedhor.

Të përditësojë dhe përmbyllë databazën me të dhënat për shtetasit që në vite kanë qenë pjesë e administratës zgjedhore dhe në analizë të të dhënave të përpunojë relacion me konkluzionet përmbyllëse që dalin nga shqyrtimi i tyre, duke e trajtuar çështjen nga këndvështrimi historik i sjelljes politike të subjekteve zgjedhore gjatë proceseve zgjedhore;

Të zbatojë në praktikë rregullat e miratuara të kontrollit dhe verifikimit të shpenzimeve të financimeve të partive politike dhe fushatave elektorale.

Të vijojë zbatimin e drejtë dhe me referim në dispozitat ligjore të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Të miratojë Kodin Etik të institucionit në funksion edhe të përcaktimit të rregullave të përfaqësimit në publik të institucionit dhe të daljeve publike të anëtarëve të KQZ-së, në përputhje me



Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik, të miratuar me vendim Kuvendi.

Miratuar në datën 21.5.2020

KRYETAR
Gramoz Ruçi

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
ENTIT RREGULLATOR TË UJIT
PËR VITIN 2019**

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

Duke theksuar se treguesit kryesorë të performancës për vitin 2019 në sektorin e UK-së tregojnë që gjendja në sektor në krahasim me vitin 2018 paraqet një përkeqësim në drejtim të mbulimit të kostove direkte të O&M, ndërkohë që “Uji pa të ardhura” dhe “Norma e arkëtimit” nuk kanë përmirësim dhe mbeten në të njëjtat nivele;

Duke theksuar se ndryshimet ligjore të nevojshme, me gjithë periudhën disaveçare që diskutohen, ende nuk janë realizuar, si dhe duke nxitur qeverinë dhe të gjithë aktorët për të propozuar sa më parë ndryshimet ligjore, të cilat pritet të kenë një impakt pozitiv si në sektorin e UK-së, ashtu edhe në lidhje me pavarësinë institucionale dhe operacionale të ERRU-së, rolit të saj për mbrojtjen e konsumatorit, përcaktimin e saktë të kompetencave dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave, rritjen e efektivitetit etj;

Duke vlerësuar faktin që në kuadër të reformës në sektor qeveria ka marrë përsipër financimin dhe prokurimin e ujëmatësve të mëdhenj për të gjithë shoqëritë UK për të bërë të mundur matje të saktë të sasisë së ujit të prodhuar;

Vlerëson për vitin 2019

Miratimin nga ERRU-ja, në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve për garantimin e një zgjidhjeje sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të tyre, të rregullores "Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të Faqe | 5648

licencuar”, një rekomandim i lënë në mënyrë të përsëritur në dy rezolutat e fundit të Kuvendit të Shqipërisë.

Faktin që ERRU-ja, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, ka marrë gjithmonë në konsideratë faktorin e përballueshmërisë në miratimin e tarifave dhe për shoqëritë të cilat ERRU ka analizuar dhe aprovuar tarifën gjatë vitit 2019 kriteri i përballueshmërisë është plotësuar në të gjitha rastet.

Rritjen e numrit të ujëmatësve të instaluar me 50 000 matësa, pothuajse nga të gjitha shoqëritë UK. Kjo rritje sjell një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e treguesit “Niveli i Matjes”.

Vlerëson investimet e bëra gjatë vitit 2019 në sektorin Ujësjellës-Kanalizime, investime të cilat arrijnë në afro 70 milionë euro.

Hartimin e Modelit të Raportit të Bilancit të Ujit, si një model që do të ndihmojë si ERRU-në dhe shoqëritë UK për të nxjerrë konkluzione të rëndësishme dhe rekomandime në drejtim të hartimit të planeve të veprimit për reduktimin e Ujit Pa të Ardhura.

Miratimin e draftit final (i cili do të jetë gati në momentin që do të miratohet ligji) të rishikimit të Metodologjisë së Vendosies së Tarifave, si një rekomandim i lënë në mënyrë të përsëritur në dy rezolutat e fundit të Kuvendit të Shqipërisë.

Ngritjen nga ana e ERRU-së së një platforme të saj të pavarur data bazë, e cila është lehtësisht e përdorshme nga shoqëritë e UK-së. Përmes kësaj platforme të re pritet të zgjidhet përfundimisht problemi i besueshmërisë dhe saktësisë së të dhënave që ERRU ka patur në vite për shkak të problematikave dhe varësisë së të dhënave të marra nga Drejtoria e Monitorimit të Benchmark-ut pranë AKUM.

Faktin që ERRU ka patur një bashkëpunim intensiv me Autoritetin e Konkurrencës dhe nxit bashkëpunimin edhe me institucionet e tjera, që kanë lidhje me vendimmarrjen e ERRU-së ose me sektorin e UK-së.

Bashkëpunimin me të gjithë aktorët në sektor sa u takon ndryshimeve ligjore, veçanërisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Rekomandon për vitin 2020

ERRU duhet të bëjë më shumë për realizimin e shembujve pilot të agregimit (bashkimit) të disa shoqërive UK në sektor dhe të shfrytëzojë “Platformën Ndërinstitucionale Online”, të ngritur



nga Kuvendi i Shqipërisë, e cila është në dispozicion të institucioneve të pavarura si një mjet i ri, që synon rritjen e autoritetit të institucioneve të pavarura, si dhe përfshirjen e Kuvendit të Shqipërisë si katalizator ndërmjet institucioneve të pavarura dhe atyre qeveritare për të bërë të mundur realizimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura për qeverinë.

Duke patur parasysh që “Uji pa të ardhura” vijon të mbetet në nivele tepër të larta dhe problem serioz për qëndrueshmërinë e shumë shoqërive UK, ERRU duhet të intensifikojë punën për gjetjen e rrugëve të reja efektive dhe konkrete lidhur me këtë problem. Akoma më shumë shqetësuese bëhet kjo situatë kur vërejmë që nuk ka përmirësim nga viti në vit, me gjithë miratimin e tarifave të reja nga ERRU-ja.

Në kushtet kur vihet re që shoqëritë UK janë të mbingarkuara me staf të punësuar jashtë nevojave reale dhe profesionalizmit, ERRU gjatë miratimit të tarifave të kërkojë me rigorozitet nga shoqëritë UK argumentim të plotë e të saktë për numrin e punonjësve, përshtatimin e detajuar të punës për secilin pozicion të stafit të saj dhe të refuzojë kostot shtesë të pajustifikuara për stafin e shoqërive UK. Rasti i UK Lushnjë duhet të aplikohet për të gjitha shoqëritë UK që kërkojnë shtesë stafi të pajustifikuar. Ndërkohë, lidhur me rekomandimin për alokimin e fondeve nën përgjegjësinë e Agjencisë Kombëtare të Ujit dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) për garantimin e sigurisë së objekteve me kamera sigurie, gjë e cila do të sillte një lehtësim të stafit të shoqërive UK, të shfrytëzojë “Platformën Ndërinstitucionale Online”.

ERRU të jetë aktive në përditësimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të saj përmes “Platformës Ndërinstitucionale Online”, të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë, platformë e cila është në dispozicion të institucioneve të pavarura si një mjet i ri që synon rritjen e autoritetit të institucioneve të pavarura, si dhe përfshirjen e Kuvendit të Shqipërisë si katalizator ndërmjet institucioneve të pavarura dhe atyre qeveritare për të bërë të mundur realizimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura për qeverinë.

Për eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive UK për plotësimin e kushteve të aktmiratimit të lejes higjieno-sanitare dhe të inspektimeve që lidhen me to, në bashkëpunim me

Inspektoratin Sanitar Shtetëror, të merren masa për propozimin e ndryshimeve përkatëse ligjore. Theksojmë se ky shqetësim është kërkuar të adresohet në mënyrë të përsëritur në rezolutat e miratuara dhe ende nuk ka gjetur zgjidhje.

Duke qenë se treguesi “Norma e arkëtimit” vijon të mbetet i papërmirësuar në tre vjetët e fundit, ERRU duhet të intensifikojë punën për gjetjen e rrugëve të reja efektive dhe konkrete për rritjen e normës së arkëtimit nga shoqëritë UK, si një tregues i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive UK.

Të vijojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët në sektor sa u takon ndryshimeve ligjore. Këto ndryshime ligjore janë të domosdoshme, pasi, ndër të tjera, pritet të sjellin një përcaktim më të qartë të statusit ligjor të ERRU-së, si dhe një dimension të ri lidhur me rolin e tij si institucion i pavarur në sektorin UK, por këto vijnë të vonohen për të disatin vit radhazi.

ERRU duhet të intensifikojë punën e saj për të bërë të mundur promovimin e institucionit përmes mjeteve të informimit publik, si dhe mediave sociale, ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre, si dhe për rritur besimin e konsumatorëve tek ERRU-ja për mbrojtjen e interesave të tyre. Fakti që kemi vetëm 18 ankesa në vit nga konsumatorët (krahasuar me 39 ankesa një vit më parë), ndërkohë që dihen problematikat me të cilat përballen konsumatorët në këtë sektor, tregon që mbetet akoma shumë për të bërë.

Në vazhdimësi të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve, të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe me aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për përmirësimin e performancës së sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.

Të punojë për hartimin e një udhëzuesi dhe modeli të unifikuar të Planit 5-vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK, duke marrë për bazë praktikatat më të mira të vendeve Europiane.

Miraturar në datën 21.5.2020

KRYETAR
Gramoz Ruçi

**DEKRET****Nr. 11485, datë 21.5.2020****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozim edhe të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Yasin Abidin Şahin
2. Turgay Oktay Koç
3. Driton Hasan Jaha
4. Oksana Volodymyr (Volodimir) Genkina
5. Anahi Victor Raul Martinez Maussan
6. Leonard Sefedin Kurtaj
7. Carlo Pietro D’Amata (d’Amata)
8. Ümmü Ibrahim Köse (Çakci)
9. Nurdeniz Sedat Ertaş (Kurtoğlu)
10. Adnan Sefedin Kurtaj
11. Şuayip İrfan Yurtseven
12. Arzu İsmet Bayram (Arik)
13. Ali Şiko Üstündağ
14. Hasan Ahmet Uğur
15. Burim Sadik Dema
16. Sugare Gjon Stojani (Pervorfi/Ukaj)
17. Murat Kahreman Nimani
18. Mustafa Karam Zaki Mohamed
19. Tuba Memet Remzi Uğurlu (Küşneci)
20. Ali Mehmetali Çekiç
21. Semra Mehmet Avara (Bolat)
22. Semih Ramadan Güler
23. Mustafa Şaban Kolikoğlu
24. Neslihan Cahit Kürüm (Akgün)
25. Fatma Salah Abdelrahim Elsayed
26. Ali Musa Şahin
27. Mahi İhsan Şahin (Ceylan)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 11487, datë 22.5.2020****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Madeus Halil Hasandoçi (Hasandoci)
2. Vasilika Ilirjan Kasapi
3. Merilda Besnik Shima (Lata)
4. Tiziana Remzi Kollçaku
5. Dhurata Abdulla Weitzl (Mushiqi)
6. Nadire Ali Troll (Sina)
7. Elena Albert Kolpeja
8. Ilda Ndriçim Lakra
9. Erjola Lalo Lalo
10. Rilion Ilia Mino
11. Niko Arqile Vasili (Ndina)
12. Silvana Kadri Shehu
13. Leons Çlirim Topi
14. Isilda Agron Mara (Shima)
15. Elsa Aludin Mothes (Borova)
16. Almeida Vladimir Truka (Mançe)
17. Vjola Zoi Dule
18. Urani Kristo Andoni
19. Uljan Agim Uliu
20. Aleksandrios Islam Musko
21. Adelina Misim Shehu (Xhoka)
22. Gentiana Fatmir Eisensteck (Drishti)
23. Rrokë Kolë Gropa
24. Janulla Kristo Marko

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**DEKRET**

Nr. 11491, datë 26.5.2020

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Valon Habib Gaši (Gashi)
2. Bernard Ndue Nikaj
3. Naim Abdurrahim Hoxha
4. Fitore Sabri Hoxha (Osmani)
5. Burim Ramadan Ramadani
6. Lendita Myftar Ahmeti Ramadani (Ahmeti)
7. Imer Mehmet Rama
8. Rafet Ismajl Rudi
9. Drita Ali Rudi (Demjaha)
10. Uran Jusuf Ismaili
11. Ariana Bali Musliu Shoshi (Musliu)
12. Vlora Ramush Hyseni
13. Vlora Kamber Muçiqi (Vrajolli)
14. Imer Nuha Hetemi
15. Enesa Nazmi Kermeni
16. Arsim Ferat Bllata
17. Armend Jashar Regjepagiqi
18. Aida Enver Baraku
19. Visar Tasim Tasimi
20. Liridon Bajram Dervishaj
21. Antigona Hilmi Haradinaj Dervishaj (Haradinaj)
22. Flamur Tomë Hajdaraj
23. Kushtrim Haziz Hodaj
24. Halit Ramush Gërbeshti
25. Elisabeth Erin Paul George Grezda (Seefeldt)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

AKT NORMATIV

Nr. 21, datë 27.5.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË AKTIN
NORMATIV NR.9, DATË 25.3.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NË
FUSHËN E VEPRIMTARISË
GJYQËSORE, GJATË KOHËZGJATJES SË
GJENDJES SË EPIDEMISË SË
SHKAKTUAR NGA COVID-19”,
MIRATUAR ME LIGJIN NR.30/2020**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aktin normativ nr.9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr.30/2020, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, gjykatat zhvillojnë seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, duke zbatuar masat organizative specifike për zhvillimin e proceseve gjyqësore, të nevojshme për të shmangur grumbullimet në ambientet e gjykatave dhe brenda sallave gjyqësore, sipas rregullave që miratohen në përputhje me parashikimet e pikës 4, të nenit 3, të këtij akti normativ.”.

2. Pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

3. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Kufizimin e hyrjes së publikut në ambientet e gjykatës, duke garantuar zbatimin e rregullave të vendosura për këtë qëllim;”.

b) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) zhvillimin me dyer të mbyllura të të gjitha seancave gjyqësore publike;”.

c) Në shkronjën “d”, fjalët “... të parashikuara në pikën 3, të këtij neni,” shfuqizohen.



Neni 2

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 4

**Pjesëmarrja në distancë në seanca
gjyqësore**

1. Pjesëmarrja e palëve, ndërhyrësit kryesor, ndërhyrësit dytësor, personit të tretë ose përfaqësuesve të tyre, prokurorit, të pandehurit, të paraburgosurit, avokatit mbrojtës, viktimës, viktimës akuzuese, paditësit, të paditurit civil, avokatit të shtetit, dëshmitarëve, ekspertëve, përkthyesve si dhe çdo pjesëmarrësi tjetër të përfshirë ose të interesuar, në të gjitha seancat përgatitore/gjyqësore sigurohet atje ku është e mundur dhe vetëm pasi palët kanë dhënë pëlqimin brenda një afati të caktuar nga gjykata, nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë, duke përdorur programe kompjuterike të përshtatshme për këtë qëllim.

2. Mënyra e ndërlidhjes në distancë duhet të sigurojë, në çdo rast, shikueshmërinë e ndërsjellë të personave të pranishëm në të dyja vendet e ndërlidhura dhe mundësinë e dëgjimit nga të gjitha palët. Nëse parashikohet pjesëmarrja e disa palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, secili prej tyre duhet të vendoset në kushte që të mund të shikojë dhe të dëgjojë të tjerët.

3. Në rastet kur seancat gjyqësore zhvillohen në distancë, provat, dokumentet shkresore si dhe çdo akt tjetër procedural i paraqiten gjykatës ose edhe palëve nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik si dhe dërgohen, brenda të njëjtës ditë, nëpërmjet shërbimit postar, me dërgesë të porositur. Dëftesa e marrjes në dorëzim duhet të ruhet nga palët deri në marrjen e vendimit të formës së prerë. Në rast se pala nuk i dërgon aktet, sipas kësaj pike, konsiderohet që ato nuk janë paraqitur.”

Neni 3

Aktet nënligjore

Këshillat dhe organet e administrimit gjyqësor të çdo gjykate miratojnë aktet nënligjore për masat organizative specifike për zhvillimin e proceseve gjyqësore, sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 3, të aktit normativ nr.9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në

fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

Neni 4

Dispozitë tranzitore

Afatet që kishin filluar të llogariten sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës, por u pezulluan sipas pikës 2, të nenit 3, të aktit normativ nr.9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, vazhdojnë të llogariten nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ për pjesën e paplotësuar të afatit. Afatet që duhet të fillonin gjatë periudhës së pezullimit fillojnë të llogariten sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**AKT NORMATIV
Nr. 22, datë 27.5.2020**

**PËR SHFUQIZIMIN E AKTIT
NORMATIV NR.13, DATË 2.4.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NË
FUSHËN E VEPRIMTARISË SË
SHËRBIMIT PËRMBARIMOR
GJYQËSOR, NDËRMJETËSIMIT DHE
ADMINISTRIMIT TË PROCEDURAVE
TË FALIMENTIMIT GJATË
KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË
EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA
COVID-19”, MIRATUAR ME LIGJIN
NR.34/2020**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit



të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Akti normativ nr.13, datë 2.4.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, miratuar me ligjin nr.34/2020, shfuqizohet.

Neni 2

Dispozitë tranzitore

Afatet që kishin filluar të llogariten, por u pezulluan sipas pikës 1, të nenit 3, të aktit normativ nr.13, datë 2.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, vazhdojnë të llogariten nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, për pjesën e paplotësuar të afatit. Afatet që duhet të fillonin gjatë periudhës së pezullimit, fillojnë të llogariten nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 421, datë 27.5.2020

PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS PËR ANËTARËT DHE SUBJEKTET JOANËTARE TË GRUPIT NEGOCIATOR PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN, SI DHE TË FUNKSIONARËVE TË KABINETIT TË KRYENEGOCIATORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen, si më poshtë vijon:

- a) Kryenegociatori;
- b) Funkionarët e kabinetit të Kryenegociatorit;
- c) Subjektet joanëtare të grupit negociator.

2. Nivelet e pagave për Kryenegociatorin dhe funksionarët e kabinetit të tij janë, si më poshtë vijon:

- a) Kryenegociatori barazohet në pagë me ministrin;
- b) Drejtori i kabinetit të Kryenegociatorit barazohet në pagë me pozicionin “drejtor i kabinetit të ministrit”;
- c) Këshilltari në kabinetin e Kryenegociatorit barazohet në pagë me pozicionin “këshilltar i ministrit”;

ç) Sekretari i Kryenegociatorit barazohet në pagë me pozicionin “sekretar i ministrit”.

3. Subjektet joanëtare të grupit negociator, të cilët kryejnë detyra të ngarkuara nga Kryenegociatori, përfitojnë një pagesë në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë për çdo ditë pune, e cila paguhet pas realizimit të punës së ngarkuar.

4. Për përfitimin e pagesës së përcaktuar sipas pikës 3, të këtij vendimi, subjekti joanëtar i grupit



negociator i bashkëlidh raportit të tij për punën e kryer formularin e kohëzgjatjes së punës, të hartuar në përputhje me lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Formulari i kohëzgjatjes së punës miratohet nga Kryenegociatori.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2020, të përballohen nga

buxheti i miratuar për Kryeministrinë për këtë vit.

6. Ngarkohet Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

FORMULAR I KOHËZGJATJES SË PUNËS SË SUBJEKTEVE JOANËTARE TE GRUPIT NEGOCIATOR		
Emri i subjektit:		
Detyra që i është ngarkur/kapitulli në kuadër të të cilit është kjo detyrë:		
Muaji		Viti:
Data	Dita e Punës	Përshkrimi i aktivitetit, rezultateve të arritura, materialeve të prodhuara ¹
Total		
Shpërblimi: _____ ditë pune X 6.000 lekë = _____ lekë		
_____ (Data) (emër, mbiemër, firmë e subjektit)		_____ (Data) (emër, mbiemër, firmë e Kryenegociatorit)

¹ Plotësimi i kësaj kolone duhet të jetë në përputhje me raportin tremujor të cilit i bashkëlidhet ky formular, duke iu referuar përshkrimit të aktiviteteve, rezultateve dhe materialeve në raportin tremujor.



VENDIM
Nr. 422, datë 6.5.2020

PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E
FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN
FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR
DHE DETYRAT E
KRYENEGOCIATORIT PËR
ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË
ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISE NË BASHKIMIN
EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe në vijim të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRBËRJA E GRUPIT NEGOCIATOR

1. Grupi Negociator, përgjegjës për zhvillimin e procesit teknik të negociatave të aderimit me institucionet e Bashkimit Evropian, i ngritur me vendimin nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, në kryerjen e detyrave të parashikuara në pikën 3, të kreut V, të vendimit të sipërpërmendur, përbëhet nga:

- Z. Zef Mazi, Kryenegociator;
- Znj. Fjoralba Caka, zëvendësministër i Drejtësisë, negociator përgjegjës për kriteret politike dhe kapitullin 23 të legjislacionit të Bashkimit Evropian;
- Znj. Romina Kuko, zëvendësministër i Brendshëm, negociator përgjegjës për kapitullin 24;
- Z. Sokol Dedja, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, negociator

përgjegjës për kapitujt 22 dhe 31 të legjislacionit të Bashkimit Evropian;

- Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kriteret ekonomike dhe kapitullin 33;

- Znj. Belinda Ikonimi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 1, 3, 7, 20, 28 dhe 30;

- Znj. Dajna Sorensen, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator për kapitujt 2 dhe 19;

- Znj. Vasilika Vjero, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator për kapitujt 6, 16, 29 dhe 32;

- Z. Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, negociator për kapitujt 10, 14, 15 dhe 21;

- Znj. Ermira Gjeçi, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitujt 11 dhe 12;

- Z. Roland Kristo, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitullin 13;

- Z. Oltion Rrumbullaku, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, negociator për kapitullin 25;

- Znj. Nina Guga, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, negociator për kapitullin 26;

- Znj. Ornela Çuçi, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, negociator për kapitullin 27;

- Znj. Natasha Ahmetaj, zëvendësguvernator i dytë në Bankën e Shqipërisë, negociator për kapitujt 4 dhe 17;

- Znj. Reida Kashta, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik, negociator për kapitullin 5;

- Znj. Juliana Latifi, kryetar i Autoritetit të Konkurrencës, negociator për kapitullin 5;

- Z. Ervin Mete, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, negociator për kapitullin 9;

- Znj. Elsa Dhuli, INSTAT, negociatore për kapitullin 18.

2. Grupi Negociator mbështet punën e Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Delegacionit Shtetëror sipas parashikimeve të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

3. Anëtarët e Grupit Negociator veprojnë për të përmbushur përgjegjësitë që lidhen me



procesin teknik të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian, me të cilat i ngarkon vendimi nr.749, datë 19.12.2018, i Këshillit të Ministrave.

4. Çdo anëtar i Grupit Negociator paraqet të paktën çdo tre muaj te Kryenegociatori apo me kërkesë të tij në një afat tjetër një raport mbi ecurinë e negociatave në kapitujt, për të cilët është përgjegjës, me të gjitha informacionet e nevojshme mbi veprimtaritë e anëtarit përgjegjës dhe mbi aktivitetet që lidhen me kapitullin.

5. Pas çdo takimi të Konferencës Ndërqeveritare midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, Grupi Negociator përgatit një raport mbi ecurinë e negociatave i cili i paraqitet nga Kryenegociatori Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Këshillit të Ministrave. Me kërkesë të Këshillit të Ministrave, anëtarët e ekipit negociator përgatisin dhe paraqesin raporte të veçanta, sipas kërkesës. Hartimi i raporteve të tilla bashkërendohet dhe paraqitet në Këshillin e Ministrave nga Kryenegociatori.

6. Anëtarët e Grupit Negociator bashkëkryesojnë nënkomitetet e stabilizimit dhe asociimit, Bashkimi Evropian – Shqipëri, si më poshtë vijon:

a) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Drejtësia, liria dhe siguria” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitullin 23;

b) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 1, 3, 7, 20, 28 dhe 30;

c) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Transporti, mjedisi, energjia dhe zhvillimi rajonal” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 10, 14, 15 dhe 21;

ç) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Tregtia, industria, doganat dhe tatimet” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 6, 16, 29 dhe 32;

d) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Për inovacionin, shoqërinë e informacionit dhe politikat sociale”

bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 10, 14, 15 dhe 21;

dh) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Çështjet ekonomike, financiare dhe statistikat” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 6, 16, 29 dhe 32;

e) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Bujqësia dhe peshkimi” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 11 dhe 12.

7. Anëtarët e Grupit Negociator, në bashkërendim me Kryenegociatorin, me qëllim garantimin e prioriteteve të kapitujve specifikë gjatë hartimit të programimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për sektorët, për të cilët janë përgjegjës, marrin pjesë në procesin e identifikimit të prioriteteve për mbështetje. Institucioni përgjegjës për secilin nga kapitujt e negociatave siguron zbatimin e parashikimeve të kësaj pike.

8. Sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, të përcaktuar në këtë vendim, anëtarët e Grupit Negociator janë anëtarë me të drejta të plota të Komitetit përkatës Sektorial të Monitorimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian.

9. Grupi Negociator mbështetet në funksionet e tij nga Sekretariati i Integritimit Evropian, siç përcaktohet në kreun VII, të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

II. KRYENEGOCIATORI

1. Kryenegociatori barazohet me ministrin e shtetit dhe, në zbatim të parashikimeve të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, ka përgjegjësi për kryerjen e negociatave teknike të anëtarësimit në BE për të gjithë kapitujt negociues. Në veçanti, Kryenegociatori ka këto detyra:

a) Drejton punën e Grupit Negociator;

b) Udhëzon Sekretariatit e Integritimit Evropian në zbatimin e detyrave përkatëse;

c) Siguron unitetin e veprimit të Grupit Negociator duke bashkërenduar punën e tij;

ç) Përfaqëson Grupin Negociator duke nënshkruar dhe duke përcjellë aktet e vendimit e tij;

d) Thërret takimet apo mbledhjet e Grupit Negociator dhe drejton diskutimin e anëtarëve të tij sipas agjendës së hartuar paraprakisht;



dh) Vendos për mundësinë e hapjes për publikun të mbledhjeve të Grupit Negociator;

e) Emëron një anëtar të Grupit Negociator si drejtues të një çështjeje specifike të negociatave, nëse kjo çështje trajtohet në më shumë se një kapitull të acquis të BE-së ose nëse më shumë se një anëtar i Grupit Negociator merret me të njëjtën temë;

ë) Përcjell vendimet e Grupit Negociator, që kanë të bëjnë me një kapitull të veçantë të acquis të BE-së, te kryesuesi dhe anëtarët e grupit përgjegjës ndërinstitucional të punës, së bashku me procesverbalin e mbledhjes së Grupit Negociator;

f) I propozon Grupit Negociator metodologjinë dhe afatet për përgatitjen e qëndrimit negociues për çdo kapitull nga grupi ndërinstitucional i punës, përgjegjës për kapitullin, pas një vlerësimi të plotë dhe analizës së raportit të shqyrtimit (screening) të Komisionit Evropian;

g) Paraqet pranë Bashkimit Evropian, përmes Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, qëndrimin negociues për çdo kapitull dhe çdo dokument tjetër mbështetës, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, në vijim të marrjes së opinionit nga Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian dhe shqyrtimit nga Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian;

gj) Informon institucionet e Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare të BE-së lidhur me pikëpamjet e Shqipërisë për çështjet që lidhen me negociatat e anëtarësimit, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe misioneve diplomatike të Republikës së Shqipërisë;

h) Përcjell, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, udhëzimet e Grupit Negociator për misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë;

i) I përcjell Grupit Negociator të gjitha informacionet përkatëse nga institucionet e Bashkimit Evropian, shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e tjera kandidate të BE-së;

j) Përcjell pranë shteteve të BE-së, institucioneve të BE-së dhe vendeve të tjera kandidate, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, kërkesat e Grupit Negociator për informacion dhe mendime lidhur me hartimin e qëndrimeve negociuese dhe çdo

kërkesë tjetër të Grupit Negociator për informacion të nevojshëm në lidhje me një kapitull të veçantë apo me procesin e negociatave;

k) Miraton kërkesat e Grupit Negociator në lidhje me angazhimin profesional të organizatave profesionale apo çdo subjekti të ndryshëm nga anëtarët e Grupit Negociator dhe kryen angazhimin e ekspertëve të fushave të ndryshme për të mbështetur kryerjen e detyrave të tij apo të detyrave dhe nevojave të grupit negociator për çështje të veçanta komplekse, pasi të ketë marrë miratimin e kryetarit të Delegacionit Shtetëror apo të personit të autorizuar prej tij. Nëse një veprim i tillë kërkon alokim fondesh shtesë, Kryenegociatori, pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për financat, paraqet përmes ministrit përgjegjës për Evropën kërkesën pranë Këshillit të Ministrave;

l) I paraqet, të paktën çdo tre muaj, Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Këshillit të Ministrave një raport të konsoliduar mbi përparimin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, bazuar në raportet tremujore të anëtarëve të Grupit Negociator sipas pikës 3, të kreut I, të këtij vendimi;

ll) Bashkëkryeson Komitetin e Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri dhe është pjesë e delegacionit shqiptar në Këshillin e Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri;

m) Merr pjesë në cilësinë e zëvendëskryetarit në Delegacionin Shtetëror dhe në cilësinë e anëtarit në Komitetin Shtetëror për Integrimin Evropian;

n) Harton një udhëzim kuadër të koordinimit të punës së Sekretariatit të Integritimit Evropian, i cili është pjesë përbërëse e rregullave të funksionimit të Sekretariatit, që miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për Evropën, sipas parashikimeve të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

nj) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së Grupit Negociator dhe kryerjen e detyrave përkatëse pas marrjes së miratimit nga kryetari i Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian;

o) Çdo detyrë dhe funksion të parashikuar në vendimin nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.



2. Kryenegociatori është Koordinatori Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian dhe siguron pjesëmarrjen e anëtarëve të Grupit Negociator në programimin dhe monitorimin e asistencës financiare të BE-së në kapitujt, për të cilët ata janë përgjegjës.

3. Kryenegociatori merr pjesë rregullisht, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Ministrave.

4. Në rastet e mungesave, të pamundësisë apo të paafësisë fizike për të vepruar të Kryenegociatorit, detyrat e përcaktuara në këtë kre kryhen nga zëvendëskryenegociatori, i cili përcaktohet me akt të veçantë të Kryenegociatorit nga radhët e negociatorëve. Zëvendëskryenegociatori kryen dhe detyra të tjera me kërkesë të Kryenegociatorit.

III. KABINETI I KRYENEGOCIATORIT

1. Kabineti i Kryenegociatorit funksionon pranë Kryeministrit dhe në Misionin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Struktura dhe funksionimi i tij miratohen me urdhër të Kryeministrit.

2. Kabineti në koordinim me njësinë përgjegjëse për nismat ligjore prioritare dhe *acquis* në Kryeministri dhe Sekretariatit e Integritimit Evropian i siguron Kryenegociatorit ndihmën e duhur teknike dhe asistencën administrative për të mbështetur zbatimin e detyrave të tij.

3. Funkionarët e kabinetit të Kryenegociatorit emërohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të Kryenegociatorit.

IV. RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË GRUPIT NEGOCIATOR

1. Projektpropozimet për qëndrimet negociuese, të hartuara nga grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të *acquis*, shqyrtohen nga anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin. Anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin, propozon qëndrimin e Grupit Negociator për projektpropozimet për qëndrimet negociuese para se ato t'i përcillen Komitetit Shtetëror për Integritimin Evropian, sipas vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

2. Vlerësimi analitik i harmonizimit të legjislacionit vendas me *acquis*, i përgatitur sipas vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të

Ministrave, nga grupi ndërinstitucional i punës për integritimin evropian për çdo kapitull shqyrtohet nga anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin.

3. Anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin, propozon qëndrimin e Grupit Negociator për vlerësimin analitik para se Grupi Negociator të vendosë formën përfundimtare të vlerësimit analitik që do t'i paraqitet Komisionit Evropian.

4. Takimet e Grupit Negociator thirren nga Kryenegociatori dhe mbahen të paktën një herë në muaj. Një ftesë me shkrim u dërgohet anëtarëve të Grupit Negociator të paktën pesë ditë para takimit. Projektrendi i ditës së mbledhjes, procesverbali i mbledhjes së mëparshme dhe materialet e tjera të rëndësishme do t'u dorëzohen anëtarëve të Grupit Negociator së bashku me ftesën me shkrim.

5. Pjesëmarrja në takime është e detyrueshme. Në rast të pamundësisë për të marrë pjesë, anëtari i Grupit Negociator informon Kryenegociatorin përpara datës së takimit dhe cakton një përfaqësues zëvendësues për të marrë pjesë në takim.

6. Takimet e Grupit Negociator kryesohen nga Kryenegociatori dhe konsiderohen të vlefshme vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në fillim të çdo mbledhjeje miratohet procesverbali i mbledhjes së mëparshme. Anëtarët e Grupit Negociator kanë të drejtë të bëjnë komente me shkrim para mbledhjes ose gojarisht gjatë takimit. Pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes së mëparshme dhe me propozimin e Kryenegociatorit, miratohet rendi i ditës i mbledhjes. Në raste të justifikuara dhe urgjente, me propozimin e Kryenegociatorit ose të një anëtari të Grupit Negociator, rendi i ditës së mbledhjes mund të ndryshohet dhe të plotësohet me materiale ose dokumente që nuk ishin përfshirë fillimisht. Ndryshimet në rendin e ditës kërkojnë miratimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm të Grupit Negociator.

7. Nëse është e nevojshme, me ftesë të Kryenegociatorit, në mbledhjet e Grupit Negociator mund të marrin pjesë edhe ekspertë që nuk janë anëtarë të Grupit Negociator.



Ekspertët marrin pjesë në diskutim pa të drejtë vote.

8. Informacioni dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi Negociator mund të jenë të disponueshme për publikun, me vendim të Kryenegociatorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Udhëzimet në lidhje me deklaratat publike ose paraqitjen publike të një anëtarit të Grupit Negociator jepen nga Kryenegociatori.

9. Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit Negociator kanë të drejtën e aksesit në informacionin e klasifikuar në lidhje me fushën e përgjegjësisë së tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës.

10. Qëndrimet e Grupit Negociator miratohen me votim. Votimi është i hapur. Një vendim konsiderohet i miratuar nëse merr shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm të Grupit Negociator.

11. Procesverbali i takimit të Grupit Negociator përgatitet nga Sekretariati i Integritetit Evropian. Drafti i procesverbalit të mbledhjes u komunikohet në mënyrë elektronike anëtarëve të Grupit Negociator jo më vonë se një javë pas mbledhjes. Takimet e Grupit Negociator mund të regjistrohen. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryenegociatori.

12. Në mbledhjen e parë të Grupit Negociator miratohet rregullorja e brendshme e funksionimit.

V. TRAJTIMI FINANCIAR

1. Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit Negociator, përveç pagës së tyre mujore, përfitojnë dhe shpërblim për rezultatet, sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

2. Subjektet joanëtare të Grupit Negociator mund të përfitojnë, sipas angazhimit të tyre dhe detyrave specifike të akorduara nga Kryenegociatori, një pagesë në përputhje me përcaktimet e vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

3. Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve të Grupit Negociator do të mbulohen nga autoritetet shtetërore dhe organet e administratës shtetërore në të cilat janë punësuar anëtarët e Grupit Negociator, në përputhje me legjislacionin që rregullon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për

punonjësit e ministrive e të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit.

4. Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve të Grupit Negociator, të cilët nuk janë të punësuar nga autoritetet shtetërore dhe organet e administratës shtetërore, do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për Evropën, në përputhje me legjislacionin që rregullon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive e të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit.

5. Urdhrat e udhëtimit për Kryenegociatorin miratohen nga Kryeministri apo një person i autorizuar prej tij.

6. Udhëtimet për shërbim jashtë shtetit për anëtarët e Grupit Negociator propozohen për miratim nga Kryenegociatori tek autoriteti shtetëror që mbulon shpenzimet përkatëse.

7. Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit Negociator i paraqesin raport me shkrim Kryetarit të Delegacionit Shtetëror, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda 7 (shtatë) ditëve nga përfundimi i udhëtimit të punës.

VI. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kryenegociatori dhe kabineti i tij ndihmës të shtohen si njësi organizative e veçantë në strukturën e Kryeministrit.

2. Rregullimet lidhur me burimet njerëzore dhe ato financiare për Grupin Negociator do të bëhen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike, anëtarët e Grupit Negociator dhe institucionet e përmendura në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



UDHËZIM
Nr. 15, datë 26.5.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019
“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE
TË REGJISTRIMIT NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 4 e Kreut I, ndryshohet si më poshtë:

“4. Aplikimi i maturantëve/kandidatëve me formularët A1 dhe A1Z bëhet në portalin e maturës shtetërore online www.matura.qsha.gov.al, për programet e ciklit të parë të studimeve, për programet e studimeve me karakter profesional, për programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, dhe programet e dyta të studimit që nuk janë të të njëjtit cikël studimi në institucionet e arsimit të lartë.”.

b) Pas pikës 10, të Kreut I, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

“11. MASR i përcjell zyrtarisht QSHA-së dhe RASH-it listën e programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë dhe numrin e kuotave të studimit për secilin prej programeve.”.

c) Në pikën 1, të shkronjës “C”, të Kreut II, fjalët “deri në 10 (dhjetë)” zëvendësohen me fjalët “deri në 7 (shtatë)”.

d) Pas pikës 6, të shkronjës “C”, të Kreut II, shtohen pikat 7, 8 dhe 9, me këtë përmbajtje:

“7. Të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përllogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishojnë në mjediset publike, si dhe në faqen e zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e

kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

8. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ngarkojnë brenda afatit të përcaktuar në kalendar, një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

9. Kuotat e paplotësuara në përfundim të raundit të parë për çdo program studimi, mund të përshtaten nga IAL në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël të ofruara brenda të njëjtës njësi kryesore, pa kaluar totalin e kuotave për njësi kryesore, dhe njofton zyrtarisht MASR për vendimin e senatit akademik mbi përshtatjen e kuotave të programeve të studimit. Në rast se përshtatja e kuotave është sipas përcaktimeve ligjore, MASR njofton IAL-të, RASH dhe QSHA për konfirmimin e përshtatjes së kuotave.”.

e) Në pikën 1, të shkronjës “E”, të Kreut II, fjalët “deri në 10 (dhjetë)” zëvendësohen me fjalët “deri në 5 (pesë)”.

f) Pika 5, e shkronjës “B” të Kreut II, pika 6 e shkronjës “C” të kreut II dhe pika 5 e shkronjës “E” të Kreut II, shfuqizohen.

g) Në pikën 2 dhe 5, të shkronjës “A”, të Kreut III, fjalët “7 faza 48-orëshe”, zëvendësohen me fjalët “6 faza 48-orëshe”.

h) Fjalja e fundit e pikës 7, e shkronjës “G”, të Kreut III, ndryshohet si më poshtë: “IAL-të gjatë regjistrimeve respektojnë renditjen e raundit paraardhës të kandidatëve deri në plotësimin e kuotave.”.

i) Në pikat 2 dhe 5, të shkronjës “D”, të Kreut III, fjalët “5 faza 48-orëshe”, zëvendësohen me fjalët “4 faza 48-orëshe”.

j) Në pikën 4, të Kreut IV/1, fjalët “në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit”, shfuqizohen.

k) Pika 3, e Kreut IV/2, ndryshohet si më poshtë:

“3. Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe plotësojnë:



a) kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për vitin përkatës akademik, me përjashtim të kategorive të përjashtuara në këtë vendim;

b) kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit për të cilët aplikojnë.”.

l) Në pikën 2, të Kreut IV/4, pas fjalëve “të shpallin”, shtohen fjalët “në Portalin U-Albania”.

m) Pikat 4 dhe 5, të kreut IV/4, ndryshohen si më poshtë:

“4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve publike dhe jopublike në Portalin U-Albania, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

5. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në Portalin U-Albania dhe në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

n) Fjalja e dytë e pikës 13, të Kreut IV/4, ndryshohet si më poshtë:

“Kandidatët fitues regjistrohen në Portalin U-Albania dhe pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit”.

o) Pas pikës 17, të kreut IV/4, shtohet pika 18) si më poshtë:

“Për çdo vit akademik, brenda datës 30 nëntor, RASH-i përcjell me shkresë zyrtare në QSHA regjistrimet përfundimtare të ciklit të dytë, në format elektronik, të dhënat e mëposhtme:

a) emri i IAL;

b) njësia kryesore e IAL-së;

c) cikli i studimit;

d) programi i studimit;

e) data e regjistrimit;

f) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar;

g) IAL në të cilën ka kryer ciklin e parë të studimeve”.

p) Në pikën 9 të kreut IV/6, shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g. Kopje e njësuar e librezës së punës.”.

q) Pas pikës 1 të Kreut V, shtohet pika 1/1 më këtë përmbajtje:

“1/1. Çdo regjistrim i kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, këtë udhëzim dhe jashtë datave të përcaktuara në kalendarin e procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, të miratuar nga QSHA dhe RASH, konsiderohet i pavlefshëm dhe kandidatët nuk pajisen me numër matrikullimi.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

NJOFTIM
Nr. 5605, datë 21.5.2020

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës, në lidhje me themelimin dhe ushtrimin e aktivitetit të Agjencisë Franceze të Zhvillimit, të *Proparco* dhe të *Expertise France* në Shqipëri, do të hyjë në fuqi më 19 qershor 2020.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë